



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:227838

Datë: 02.03.2023

Numri i dokumentit: 04036145

C.nr. 1130/2011

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NQ "T." Sh.a me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson F. Sh., kundër të paditurit I. G. me adrese në Rr. "Dardania", ..., nr.... në Prishtinë, për pagesën e borxhit, vlera e kontestit 535.57 €, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur, në prani të të autorizuari të paditësit e në mungesë të të paditurit me datën 28.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRESI SI E THEMELTË kërkesëpadia e paditësit NQ "Termokos" Sh.a me seli në Prishtinë, DETYROHET i padituri I. G. me adrese në Rr. "Dardania", ..., nr.... në Prishtinë, që paditësit në emër të borxhit për ngrohje për periudhën nëntor, dhjetor të vitit 2007, janar, shkurt, mars, prill, dhjetor të vitit 2008, janar, shkurt, mars, prill, maj, të vitit 2009, t'i paguaj shumën prej 535.57 €, me kamatë ligjore në lartësi të cilën e paguajnë bankat ligjore si për mjetet e afatizuar për një vit, pa destinim të caktuar duke filluar nga data 27.05.2009, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimeve e procedurës në shumën prej 15€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi fillimisht, për realizimin e këtij borxhi në këtë gjykatë ka bërë propozim përmbarimi me datën 27.05.2009, i cili përmbarim është lejuar me Aktvendimin e kësaj gjykate E.da.n.1828/2009, dt. 27.05.2009, por që në të njëjtin ka bërë kundërshtim i padituri dhe sipas Konkluzionit E.da.nr. 1828/2009 të datës 27.05.2009, propozimi trajtohet si padi dhe përcjellët për shqyrtim në procedurë kontestimore.

I padituri përmes kundërshtimit të datës 14.02.2011 e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke shtuar se unë jam i paditur të paguaj borxh pa borxh, nga se për periudhat për të cilat jam paditur nuk kam pasur ngrohje fare, dhe si të tillë tërë borxhin e ka kundërshtuar në tërësi. Po ashtu i njëjti e ka kundërshtuar edhe Kartelën e Kontabilitetit si provë që ka propozuar nga Termokosi, dhe duke kërkuar që gjykata ta shpall si prove të pa pranueshme.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, në seancën gjyqësore të datës 28.02.2023 ka kërkuar që të detyrohet i padituri, si debitorë t`ia paguaj kreditorit, në emër të borxhit të papaguar për ngrohjeje qendrore shumën prej 535.57€, për periudhën nëntor, dhjetor të vitit 2007, janar, shkurt, mars, prill, dhjetor të vitit 2008, janar, shkurt, mars, prill, maj, të vitit 2009. Nga të larte cekurat i ka kërkuar gjykatës që të aprovet kërkesëpadia në tërësi si e bazuar, pasi që me provat e administruara u vërtetua në tërësi baza e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumen prej 15 €.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 28.02.202 paditësi nuk ka prezantuar edhe pse ka qene i ftuar në mënyrë të rregullt, gjykata aprovoj propozimin e të autorizuarit të palës paditëse që seanca të mbahet në mungesë të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 28.02.2023, bëri administrimin e provave dhe atë kartelën e konsumatorit e datës

26.05.2009 për periudhën 2007-2009, propozimin e përbarimit, kundërshtimin e të paditurit si dhe kartelën e konsumatorit për periudhën 2000-2022 për të paditurin.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga kartela e konsumatorit - e të paditurit, lëshuar nga paditësi për periudhën kontestuese nëntor, dhjetor të vitit 2007, janar, shkurt, mars, prill, dhjetor të vitit 2008, janar, shkurt, mars, prill, maj, të vitit 2009, të siguruara si provë nga paditësi, vërtetohet se i padituri ka detyrim ndaj paditësit për ngrohje të pa paguar shumën prej 535.57 €.

Gjykata vlerëson se i padituri nuk ka prezantuar kurrfarë prova relevante me çka do të argumentonte të kundërtën nga ajo çka pretendon paditësi, dhe gjithashtu gjykata konstatoj se i padituri për këta dymbëdhjetë muaj nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditësit.

Si rezultat i kësaj i padituri, për shkak të mos pagesës së borxhit për shërbimin e ngrohjes qendrore të ofruar nga paditësi, ka hyre në raport detyrimor me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit kurse e paditura e ka cilësinë e debitorit.

Sipas nenit 262 par.1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve, kreditori në marrëdhënien detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit kurse debitori është detyruar që ta përmbushë detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi siç kanë paraparë, me parë.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 277 të LMD-ës.

Në kuptim të gjendje faktike të vërtetuar e duke aplikuar të drejtën material sipas dispozitave të cituar gjykata gjeti së kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa kundërshtimet e të paditurit nuk u konsideruan të rëndësishme për të vendosur ndryshe.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452, të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Mbi bazën e te dhënave si me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 1130/2011 i datës 28.02.2023

Përparim Zeka

Gjyqtar

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.